

RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR MËNYRËN E ZHVILLIMIT TË PROVIMEVE

VITI AKADEMIK 2022 - 2023

1. Sistemi i vlerësimit në Universitetin POLIS bëhet me sistemin me 10 nota. Për çdo vlerësim të studentit me notën nga 4 (katër) e poshtë, studenti shpallet jokalues dhe është i detyruar të përsërisë lëndën. Për çdo vlerësim të studentit me notën nga 5 (pesë) e sipër, studenti shpallet kalues.

Nota/Grade	Përshkrimi/Description	GPA	Letter/Grade
10	Shkëlqyeshëm/ Excellent	4	A, A+
9	Shumë mirë/ Very good	3.7 3.3	A- B+
8	Mirë / Good	3	B
7	Kënaqshëm /Satisfactory	2.7 2.3	B- C+
6	Mjaftueshëm / Sufficient	2.0 1.7	C C-
5	Kalueshëm / Pass	1.3 1.0	D+ D
1-4	Ngelës / Insufficient	0.0	F

Studenti përveç pjesës së notave mund të përballet dhe me dy vlerësime si:

PENGESË (P) = nuk ka shlyer detyrimet e përcaktuara në syllabusin e lëndës

NUK KLASIFIKOHET (NK) = studentit nuk ka frekuentuar lëndën në masën e kërkuar 75 %

2. Kreditet e nevojshme për **kalimin nga viti në vitin pasardhës** studentit duhet të ketë kaluar një numër të caktuar kreditesh si më poshtë:
- Për të gjitha programet e studimit, studentit i vitit të parë kalon në vitin e dytë nëse ai ka marrë jo më pak se 50% të krediteve (30 kredite) të vitit të parë.
 - Studentit i vitit të dytë kalon në vitin e tretë, nëse ai ka marrë jo më pak se 80 kredite nga të cilat 50 kredite nga viti i parë.
 - Për programet e studimit të integruara të ciklit të dytë, studentit i vitit të tretë kalon në vitin e katërt, nëse ai ka marrë jo më pak se 140 kredite nga të cilat të gjitha kreditet e vitit të parë dhe të dytë.
 - Studentit i vitit të katërt kalon në vitin e pestë, nëse ai ka marrë jo më pak se 200 kredite nga të cilat të gjitha kreditet e vitit të parë, të dytë dhe të tretë.

Kredite te nevojshme per kalimin ne vitin pasardhes		Total	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	
Viti 1	Viti 2	30	30				ETCS
Viti 2	Viti 3	80	50	30			ETCS
Viti 3	Viti 4	140	60	60	20		ETCS
Viti 4	Viti 5	200	60	60	60	20	ETCS

3. Nëse studentët në **përfundim të vitit të parë kanë** lëndë të prapambetura ata mund ti shlyejnë ato në sezonin e vjeshtës në muajin shtator të vitit aktual, pa asnjë detyrim ekstra financiar, me përjashtim të lëndëve studio të cilat nuk jepen si provime në vjeshtë.
4. Studentët të cilët **në përfundim të vitit të parë** nuk arrijnë të marrin **30 kredite nga 60 të tilla** që ka viti i parë, atëherë merret vendim përjashtimi me pa të drejtë regjistrimi sërish në Universitetin POLIS.
5. Studentët **e viteve të ndërmjetme** të cilët kanë lëndë të prapambetura duhet të respektojnë procedurën e mëposhtme:
 - a) Të bëjnë kërkesë nëpërmjet e-mail sekretaria@universitetipolis.edu.al ose sistemit elektronik PITAGORA, për provimin që duan të shlyejnë.
 - b) Të kryejnë pagesën 50 euro për çdo provim që duan të shlyejnë para dates se provimit.
 - c) Përmirësimet për notë realizohen vetëm në sezonin e vjeshtës dhe lejohet vetëm një lëndë për vit akademik. Mbetet në fuqi nota me të cilën studenti vlerësohet në fund.
 - d) Lëndët studio nuk mund të shlyhen në sezonin e vjeshtës.
 - e) Kreditet maksimale që një student mund të shlyejë në një vit akademik nuk i kalon 20 ECTS.
6. Studentët e të gjitha viteve marrin informacion në lidhje me mungesat vetëm nëpërmjet sistemit elektronik PITAGORA, dhe pedagogut të lëndës.
7. Studentët e të gjitha viteve marrin informacion në lidhje me notat vetëm nëpërmjet sistemit elektronik PITAGORA, dhe pedagogut të lëndës.
8. Studentët të cilët nuk kanë kryer tarifën semestrale nuk kanë të drejtë të hyjnë në provime.

PËR MË SHUMË INFORMACION RRETH RREGULLOREVE DHE PROCEDURAVE MUND TË SHIKONI NË PORTALIN TUAJ PITAGORA OSE NË LINKUN:

<https://universitetipolis.edu.al/guida-e-studentit/>

Për çdo paqartësi kontaktoni në: sekretaria@universitetipolis.edu.al